



MONITORIMI I SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO-VIZUELE GJATË FUSHATËS PËR ZGJEDHJE LOKALE - 2013

Periudha monitoruese 3 tetor – 3 nëntor 2013

Hyrja dhe Baza Ligjore

Domosdoja e organizimit të monitorimit të shërbimeve mediale audio-vizuele gjatë zgjedhjeve buron jo vetëm nga rëndësia që kanë zgjedhjet si ngjarje politike, por edhe nga roli që i është dhënë Komisionit të Pavarur për Media në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Sipas tij, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit (shërbimet mediale audio-vizuele).

Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele me Kreun VIII të këtij Ligji, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës të KPM-së, ka bërë monitorimin e shërbimeve mediale audio-vizuele gjatë mbulimit të fushatës për Zgjedhjet Lokale 2013.

Në monitorim janë përfshirë 24 shërbime mediale audio-vizuele, nga të cilat 3 televizionet nacionale, 17 televizione regjionale dhe lokale si dhe 4 ofrues të shërbimeve programore (OSHP).

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerr Udhëzuesin i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të kreut VIII dhe i cili përbëhet prej:

1. KAPITULLIT – 1 identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLIT – 2 raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLIT – 3 periudha e heshtjes së mediave.

Metodologjia dhe Realizimi

Metodologjitë e përdorura gjatë monitorimit të performancës së shërbimeve mediale audio-vizuele në periudhën e Zgjedhjeve Lokale 2013, janë analiza kuantitative dhe kualitative.

Aktivitetet e ndërmarra me qëllim të arritjes së treguesve kuantitativ të mbulimit të fushatës parazgjedhore kanë përfshirë regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, matjet e hapësirës së dedikuar secilit subjekt të certifikuar politik, dizajnimin e tabelave për futjen e të dhënave, përpunimin dhe analizën e të dhënave të fituara si dhe hartimin e raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore.

Metodologjia kualitative ka përfshirë vlerësimin e prezantimit të fushatës parazgjedhore në shërbimet mediale audio-vizuele. Për këtë qëllim janë bërë analiza nëse prezantimet e fushatave janë bërë në mënyrë: pozitive, neutrale ose negative.

Gjithashtu është analizuar nëse shërbimet mediale audio-vizuele kanë vepruar në pajtueshmëri me dispozitat që dalin nga kapitulli VIII i Ligjit për Zgjedhje dhe Udhëzuesi i KPM-së.

Fokus i monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe prej orës 17:00 deri 24:00.

Gjetjet nga monitorimi i performancës së mediave gjatë fushatës për Zgjedhjet lokale 2013 janë përmbledhur në këtë raport.

Gjetjet nga Monitorimi

Monitorimi i shërbimeve mediale audio-vizuele gjatë mbulimit të fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale 2013, ka dëshmuar se ato kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, duke raportuar në përgjithësi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Përmes lajmeve, kronikave zgjedhore, debateve, intervistave e spoteve politike, shërbimet mediale audio-vizuele të monitoruara, kanë ofruar hapësirë dhe mundësi për prezantimin e fushatave dhe shpalosjen e platformave politike të Subjekteve Politike të Çertifikuara.

Sa i përket distribuimit të kohës për SPÇ-të, shërbimet mediale audio-vizuele kanë arritur balancim më të madh kryesisht tek partitë më të mëdha politike. Kjo, për faktin se edhe intensiteti i fushatave dhe aktivitetëve të tyre ishte më i madh.

Hapësirë e mjaftueshme për prezantimin e programeve të tyre politike dhe aktivitetet paraelektorale u është ofruar edhe SPÇ-ve më të vogla.

Nga monitorimi është gjetur gjithashtu se shumica e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë qenë të vëmendshëm që edhe renditje në prezantimi i fushatave të SPÇ-ve të jetë përgjithësisht e balancuar.

Gjatë periudhës monitoruese, shërbimet mediale audiovizuale kanë ofruar edhe materiale edukuese lidhur me procesin e votimit, që konsiderojmë se ishte ndihmesë për qytetarët në ditën e votimit, më 03 nëntor 2013.

Të dhënat në raport lidhur me hapësirën e dhënë Subjekteve Politike të Certifikuara, janë vetëm për kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 17:00-24:00 kur edhe janë bërë monitorimet.

Shkeljet e gjetura dhe veprimet e KPM-së

Shkeljet më të shpeshta të identifikuar gjatë monitorimeve ishin shkeljet për mos identifikim të spoteve politike dhe tejkalim të minutazhit të tyre, që përbëjnë shkelje të nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme .

Gjatë monitorimeve është gjetur gjithashtu se disa shërbime mediale audio-vizuale kanë transmetuar spote reklamuese, pjesë përbërëse e të cilave janë edhe fëmijët, gjë që paraqet shkelje të nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, sipas të cilit përcaktohet se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike”.

Pas Njoftimeve për Shkelje, shkresave dhe komunikimit me shërbimet mediale audio-vizuale lidhur me këto shkelje, shumica e tyre ka ardhur në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhje dhe Kapitullin 1 të Udhëzuesit të KPM-së për identifikim të reklamimit politik si dhe Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale.

Për mos-ofrim të qasjes së drejtë dhe të paanshme, KPM ka ngritur zyrtarisht raste ligjore për shkelje të nenit 48 të Ligjit për Zgjedhje.

Nga monitorimi i heshtjes zgjedhore që ka filluar më 02 nëntor nga ora 07:00 dhe ka përfunduar me mbylljen zyrtare të vendvotimeve më 03 nëntor 2013, është gjetur se shumica e televizioneve të monitoruara kanë vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzuesin e KPM-së për Periudhën e Heshtjes së Mediave.

Në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me periudhën e heshtjes së mediave dhe Udhëzuesin e KPM-së kanë vepruar OSHP- Klan Kosova, TV Syri Vision dhe TV Mir, të cilët menjëherë pas votimeve kanë transmetuar deklaratat e kandidatëve për kryetarë të komunave në këto zgjedhje, transmetimi i të cilave përbën shkelje të nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje.

Lidhur me shkeljet e gjetura, KPM ka ndërmarr veprime të parapara me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Gjetjet nga monitorimi i aktivitetit të fushatës parazgjedhore të Zgjedhjeve Lokale 2013			
Nr	Shërbimet Mediale Audio-Vizuale	Gjetjet e KPM-së	Veprimet e KPM-së
1	TV Dukagjini	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
2	RTV 21	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
3	RTK1	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
4	RTK2	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
5	TV Mir	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
6	TV Herc	Shkelje e nenit 9.8 të Kodit të Sjelljes	Vërejtje
7	TV Syri Vision	Shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Njoftim për Shkelje, Vërejtje dhe Urdhër
8	Radio Gora	Shkelje e nenit 22.3.1 të Ligjit të KPM-së	Vërejtje
9	Radio Kompas	Shkelje e nenit 22.3.1 të Ligjit të KPM-së	Vërejtje
10	Tv Mir	Shkelje e nenit 22.3.1 të Ligjit të KPM-së	Vërejtje
11	Radio Premiera	Shkelje e nenit 22.3.1 të Ligjit të KPM-së	Vërejtje
12	OSHP Klan Kosova	Shkelje e nenit 52.1 të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme	Rasti në procedurë
13	TV Mir	Shkelje e nenit 52.1 të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme	Rasti në procedurë
14	TV Syri Vision	Shkelje e nenit 52.1 të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme	Rasti në procedurë

Ankesat e paraqitura në KPM dhe veprimet e ndërmarra lidhur me to

Gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore, në KPM janë parashtruar 10 ankesa të SPÇ-ve ndaj shërbimeve mediale audio-vizuale.

Kryesisht, ankesat kishin të bëjnë me shkelje të nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme , sipas të cilit, mediat duhet të sigurojnë qasje të drejtë dhe të paanshme për të gjitha subjektet politike të certifikuar. Dy ankesa tjera pretendojnë shkelje të nenit 49.2, sipas të cilit shërbimet mediale audio-vizuale që emetojnë hapësirë reklamuese me pagesë, kanë obligim të ofrojnë hapësirë të caktuar pa pagesë secilit SPÇ.

Lidhur me ankesat e parashtruara, janë bërë monitorime për të verifikuar nëse janë të bazuara dhe pastaj janë ndërmarr veprime ligjore të parapara me nenin 30 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ankesat e SPÇ-ve dhe veprimet e KPM-së			
Nr	Ankesat e SPÇ vs Shërbimet Mediale Audio-Vizuale	Gjetjet e KPM-së	Veprimet e KPM-së
1	AKR vs TV Syri Vision	Shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Njoftim për Shkelje, Vërejtje Urdhër dhe Rekomandim
2	Nisma Qytetare për Ferizajn vs Klan Kosova	Shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Vërejtje
3	Nisma Qytetare për Ferizajn vs RTK	E pa bazuar	Njoftimi i palës ankuese
4	Nisma Qytetare për Ferizajn vs KTV	E pa bazuar	Njoftimi i palës ankuese
5	Bashkimi Demokratik vs RTK1	E pa bazuar	Njoftimi i palës ankuese
6	Të Pavarurit e Mitrovicës vs RTV21	Deri në përfundim të zgjedhjeve SPÇ-së i është ofruar hapësira (pa pagesë) sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Shkresë RTV21 lidhur me ankesën e palës
7	Të Pavarurit e Mitrovicës vs KTV	Deri në përfundim të zgjedhjeve SPÇ-së i është ofruar hapësira (pa pagesë) sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Shkresë KTV-së lidhur me ankesën e palës
8	Lëvizja Sociale e Kosovës vs KTV	Kandidati është ftuar në debat- (Ankesa është e pabazuar)	-
9	Lëvizja Sociale e Kosovës vs Klan Kosova	Shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Vërejtje
10	AAK vs Radio Fontana	Ankesa ka arritur pas fushatës dhe është në proces	-

Prezantimi i fushatave të SÇP-ve në tri televizionet nacionale

Analizat dhe matjet e materialeve të transmetuara gjatë periudhës monitoruese kanë dëshmuar se tri televizionet nacionale kanë prezantuar kryesisht në mënyrë neutrale fushatat e SPÇ-ve. Sa i përket distribuimit të kohës ato kanë arritur balancim më të madh kryesisht tek partitë më të mëdha politike. Kjo për faktin se edhe intensiteti i fushatave dhe aktiviteteve të tyre ishte më i madh.

Debatet ishin formë e ballafaqimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve për kryetar komunash. Ato u organizuan në 3 TV nacionale dhe pothuajse edhe në të gjitha shërbimet tjera mediale audio-vizuele. Në to kandidatëve iu ofrua hapësirë që të shpalosin programe e tyre politike, të bëjnë replika me njëri tjetrin e gjithashtu të dërgojnë edhe mesazhet e tyre për qytetarët.

Është karakteristike të përmendet se edhe renditja në prezantim të fushatave të SPÇ-ve ishte përgjithësisht e balancuar.

Prezantimin i garës për kryeqytetin zuri vend të rëndësishëm në mbulimin medial të tri televizionet nacionale.

RTK 1 – Me mbulimin e gjithanshëm të fushatave parazgjedhore të SPÇ-ve, Televizioni Publik i Kosovës ka pasqyruar atmosferën elektorale në të gjitha komunat e Kosovës. Raportimi ishte korrekt, megjithëse vërehet se në kronika zgjedhore dhe edicionet e lajmeve, RTK ka ofruar hapësirë pak më të madhe për PDK-në.

Gjetjet nga monitorimi dëshmojnë se ky shërbyes media audio-vizuel ishte i vëmendshëm edhe sa i përket renditjes në prezantimin e fushatave të SPÇ-ve.

Kronikat zgjedhore të SPÇ-ve të minoriteteve janë transmetuar para periudhës monitoruese dhe prandaj nuk janë të përfshira në këtë raport.

Televizioni Publik i Kosovës ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: RTK			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	24493	26.14	1	PDK	130812	15.46
2	LDK	19944	21.29	2	LDK	130432	15.42
3	VV	12216	13.04	3	VV	126166	14.91
4	AKR	9408	10.04	4	AKR	72611	8.58
5	AAK/LDD	15182	16.21	5	AAK/LDD	126119	14.91
6	LB	2076	2.22	6	LB	28086	3.32
7	PSD	959	1.02	7	PSD	6930	0.82
8	BD	308	0.33	8	BD	9928	1.17
9	ADK	863	0.92	9	ADK	11349	1.34
10	PD	1656	1.77	10	PD	47391	5.60
11	PF	3608	3.85	11	PF	8837	1.04
12	IQ për Lipjanin	87	0.09				0.00
13	Të Pavarurit e Mitrovicës	238	0.25	12	Të Pavarurit e Mitrovicës	5827	0.69
14	LSK	158	0.17	13	LSK	10092	1.19
15	IQ për Drenasin	492	0.53	14	IQ për Drenasin	4209	0.50
16	Lëvizja VATRA	211	0.23	15	Lëvizja VATRA	8091	0.96

				16	ZEP	8091	0.96
				17	Ylli Isufi	8091	0.96
				18	Koalicioni për Gjilanin	8091	0.96
17	PSHDK	268	0.29	19	PSHDK	8961	1.06
18	PDAK	413	0.44				0.00
				20	N.Hysenaj	3364	0.40
19	NQ për Ferizaj	163	0.17	21	NQ për Ferizaj	6163	0.73
20	PK	86	0.09	22	PK	5567	0.66
				23	IQ GTSH	6930	0.82
				24	Isuf Muslija	4670	0.55
				25	Rufki Suma	4046	0.48
21	SDP	57	0.06				0.00
22	Adriana Hodziq	49	0.05				0.00
23	IQ për Malishevën	261	0.28	26	IQ për Malishevën	3752	0.44
24	Balli Kombëtar	139	0.15	27	Balli Kombëtar	4361	0.52
				28	Aleanca për Lipjanin	4832	0.57
				29	BZNB	3940	0.47
				30	ZBNB	3940	0.47
				31	OGI	3940	0.47
				32	SGI	3940	0.47
25	SLS	86	0.09	33	SLS	3940	0.47
				34	GIS	3940	0.47
26	PDKI	261	0.28	35	PDKI	4320	0.51
				36	VAKAT	4361	0.52
				37	Nova Snaga	4986	0.59
				38	IQ Ndryshe Rahovec	4986	0.59
Total (s dhe %)		93682	100	Total (s dhe %)		846092	100.00

Në debate dhe intervistat të transmetuara gjatë periudhës monitoruese, RTK ka prezantuar 38 , SPÇ. Hapësira e dhënë është kryesisht në proporcion me numrin e komunave ku ato garojnë. Në rastet kur përkundër ftesës për debat, subjekti politik ka munguar, televizioni ka njoftuar shikuesit.

Përmes emisioneve me analistë, janë analizuar paraqitjet në debate dhe programet e kandidatëve për kryetarë të komunave.

KTV - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: KTV			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	6078	13.70	1	PDK	46149	13.54
2	LDK	8164	18.41	2	LDK	44586	13.08
3	VV	6207	13.99	3	VV	56514	16.58
4	AKR	4963	11.19	4	AKR	35286	10.35
5	AAK/LDD	7378	16.63	5	AAK/LDD	53432	15.67
6	LB	2748	6.20	6	LB	13900	4.08
7	PSD	821	1.85	7	PSD	9290	2.73
8	BD	509	1.15	8	BD	1442	0.42
9	ADK	845	1.91	9	ADK	3827	1.12
10	PD	792	1.79	10	PD	16585	4.87
11	PF	1928	4.35	11	PF	9290	2.73
12	IQ për Lipjanin	156	0.35				0.00
13	Të Pavarurit e Mitrovicës	522	1.18	12	Të Pavarurit e Mitrovicës	4420	1.30
14	IQ për Drenasin	359	0.81				0.00
15	IQ GTSH	70	0.16	13	IQ GTSH	9290	2.73
				14	Koalicioni për Gjiilan	4227	1.24
				15	Ylli Isufi	4227	1.24
				16	ZEP	4227	1.24
16	Lëvizja VATRA	349	0.79	17	Lëvizja VATRA	4227	1.24
17	Adriana Hodziq	68	0.15				0.00
18	NQ për Ferizaj	111	0.25	18	NQ për Ferizaj	4291	1.26
19	Socijal Demokratija	454	1.02				0.00
20	SLS	284	0.64				0.00
21	GI Srpska	606	1.37				0.00
22	IQ për Malishevën	402	0.91	19	IQ për Malishevën	1143	0.34
23	SDA	31	0.07				0.00
				20	Bashkimi Demokratik për Kaçanikun	1209	0.35
				21	LSK	7694	2.26
				22	Nysret Hysenaj	4111	1.21
24	Rufki Suma	221	0.50				0.00
25	PSHDK	107	0.24				0.00
26	GI SDP	182	0.41				0.00
				23	Aleanca për Lipjanin	1533	0.45
Total (s dhe %)		44355	100	Total (s dhe %)		340900	100.00

Përkundër faktit se KTV ka prezantuar në kontekst negativ për disa dukuri negative dhe shkelje të SPÇ-ve gjatë fushatës, konsiderohet se mbulimi i fushatave zgjedhore të SCP nga ky shërbim media audio-vizuel ishte i balancuar dhe korrekt. Kjo për faktin se KTV ka prezantuar në kontekst negativ për shkeljet dhe dukurit negative të shumicës së SCP-ve, gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.

Raportim në kontekst negativ

PF – mund të paditet për të drejtat e autorit për shkak të përdorimit të një kënge.

LDK – fushata në shkollë, shpërndarja e vizitkartave nga një kandidatë për asamblë nga LDK

PDK – lidhur me seancën gjyqësore të kandidatit nga ky subjekt, R.Muja

PDK- lidhur me seancën gjyqësore të kandidatit nga ky subjekt, R.Muja

IQ për Drenasin – grupi Troja do të padis këtë iniciativë për shkak të përdorimit të këngës së tyre në fushatë.

VV, LDK – mos-reagimi rreth vizitave të zyrtarëve nga Serbia në Kosovë- si herëve të kaluara.

PDK, LDK, AAK, AKR, VV – Avokati kritik për përdorim të fëmijëve në fushatë. Raporti shoqërohet me pamje nga fushatat e partive të lartshënuara.

PDK, LDK, AAK, NQ për Ferizaj - Gjobat nga PZAP për këto subjekte .

PDK, LDK, AAK, KDTP – Demokracia në Veprim lidhur me ankesat në PZAP .

LDK,AKR, PDK, AAK, VV- Shfrytëzimi i fëmijëve në fushatë. Raporti shoqërohet me pamje të fushatave të këtyre subjekteve (275s).

PDK, LDK, AAK, VV, AKR – Premtimet e partive politike. Kritika nga GAP, Lëvizja Fol (285s).

LDK, LB, PDK, AAK, AKR – Vizitat gjatë fushatës tek njerëzit me nevoja të veçanta- a sociologët i konsiderojnë të pandershme. Raporti shoqërohet me pamje nga vizitat e këtyre subjekteve.

Në debate dhe intervista KTV ka prezantuar 23 SPÇ. Hapësira e dhënë ishte në proporcion me numrin e komunave ku ato garojnë. Në rastet kur përkundër ftesës për debat, subjekti politik ka munguar, televizioni ka njoftuar shikuesit.

TV 21 – Lidhur me fushatat dhe aktivitetet e SPÇ-ve, në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore, ky shërbim medial audio-vizuel ka prezantuar në mënyrë shumë korrekte dhe të paanshme. Kjo balancë është vërejtur jo vetëm te hapësira e ofruar por edhe te mënyra e raportimit lidhur me fushatat dhe aktivitetet e Subjekteve të Çertifikuara Politike.

Hapësira e ofruar për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV 21			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	7466	15.53	1	PDK	150921	15.92
2	LDK	6401	13.31	2	LDK	133995	14.14
3	VV	6718	13.97	3	VV	186882	19.72
4	AAK/LDD	8147	16.94	4	AAK/LDD	145958	15.40
5	AKR	5343	11.11	5	AKR	74594	7.87

6	Të Pavarurit e Mitrovicës	1104	2.30	6	PD	53668	5.66
7	PSHDK	127	0.26	7	PSHDK	13785	1.45
8	BD	450	0.94	8	BD	11394	1.20
9	IQM	274	0.57	9	PK	6014	0.63
10	PD	2010	4.18	10	PDKI	5515	0.58
11	LB	2058	4.28	11	LDK-LPM	4842	0.51
12	PSD	1044	2.17	12	ISUF MUSLIU	4564	0.48
13	ADK	1953	4.06	13	ADK	11524	1.22
14	PDAK	198	0.41	14	LB	30329	3.20
15	PF	3158	6.57	15	Vatra	5411	0.57
16	IQ-SDP	103	0.21	16	Ylli Isufi	5411	0.57
17	OLIVER IVANOVIC	48	0.10	17	SDP	3318	0.35
18	SRZAN POPOVIC	39	0.08	18	Adriana Hodziq	3318	0.35
19	IQD	584	1.21	19	Nysret Hysenaj	5400	0.57
20	YLLI ISUFI	151	0.31	20	IQD	4860	0.51
21	SLS	344	0.72	21	SLS	14557	1.54
22	BK	75	0.16	22	Rufki Suma	3494	0.37
23	SNPK	50	0.10	23	PDL	4629	0.49
24	PPSK	40	0.08	24	PSD	6420	0.68
25	SocijalDemokratija	172	0.36	25	IQDSH	6420	0.68
26	IQAP	26	0.05	26	IQN	5310	0.56
				27	PF	6420	0.68
				28	IQM	4969	0.52
				29	VAKAT	5380	0.57
				30	BK	5380	0.57
				31	IQF	5150	0.54
				32	Zajednica za Buducnost	3900	0.41
				33	Narodno Jednistvo	3900	0.41
				34	LSK	4680	0.49
				35	SKK	5510	0.58
Total (s dhe %)				Total (s dhe %)			
		48083	100.00			947822	100.00

Në debatet dhe intervistat e transmetuara në TV21, janë prezantuar 35 SPÇ. Hapësira e dhënë është në proporcion me numrin e komunave ku ato garojnë. Në rastet kur përkundër ftesës për debat, subjekti politik ka munguar, televizioni ka njoftuar shikuesit.

TELEVIZIONET LOKALE/REGJIONALE

Gjatë periudhës së fushatës për zgjedhjet lokale 2013, televizionet lokale janë fokusuar më shumë në prezantimin e fushatave të SPÇ-ve në regjionet dhe komunat ku operojnë.

REGJIONI I PEJËS

TV DUKAGJINI – Ky shërbim medial audio-vizuel ishte kryesisht korrekt gjatë prezantimit të fushatës zgjedhore të SPÇ-ve. Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore hapësirë më të madhe ka ofruar për SPÇ-të: AAK/LDD, PDK, LDK dhe VV, gjë që dëshmon se prezantimi i fushatave deri diku ishte në proporcion me intensitetin e fushatave zgjedhore të SPÇ-më të mëdha. Edhe në emisionet e tipit të debatit dhe intervistat, hapësira e ofruar për subjektet tjera të certifikuar ishte kryesisht e balancuar.

TV Dukagjini ka njoftuar shikuesit çdo ditë për orarin e rezervuar për SÇP si dhe për rastet kur përkundër ftesës për debat, subjekti politik nuk e ka shfrytëzuar terminin e paraparë.

Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV Dukagjini			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debatet/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	8141	18.54	1	PDK	3900	17.03
2	AAK/LDD	12579	28.65	2	AAK/LDD	2400	10.48
3	LDK	6507	14.82	3	LDK	2400	10.48
4	ADK	2105	4.79	4	ADK	1400	6.11
5	PD	763	1.74	5	PD	2400	10.48
6	LSK	557	1.27	6	LSK	1400	6.11
7	AKR	1972	4.49	7	AKR		0.00
8	PSD	174	0.40	8	PSD		0.00
9	VV	8152	18.56	9	VV	1500	6.55
10	IRDK	177	0.40	10	IRDK	1500	6.55
11	LB	538	1.23	11	LB		0.00
12	IQD	547	1.25	12	IQD		0.00
13	PSHDK	480	1.09	13	PSHDK		0.00
14	PDKI	164	0.37	14	PDKI		0.00
15	SDA	131	0.30	15	SDA		0.00

16	Vakat	426	0.97	16	Vakat	1500	6.55
17	PFK	350	0.80	17	PFK		0.00
18	BK	148	0.34	18	BK	1500	6.55
19	SDSG		0.00	19	SDSG	1500	6.55
20	BSDAK		0.00	20	BSDAK	1500	6.55
Total (s dhe %)		43911	100	Total (s dhe %)		22900	100.00

TV SYRI VISION - Gjatë prezantimit të fushatave të subjekteve politike në lajme dhe kronika zgjedhore, TV Syri Vizion ka favorizuar koalicionin AAK/LDD. Pason PDK, LDK dhe VV. Gjetjet nga monitorimi i mbulimit të fushatës zgjedhore në lajme dhe kronika zgjedhore dëshmojnë se ky shërbyes medial audio-vizuela ka prezantuar vetëm hapjen dhe fushatën përmbyllëse të AKR-së. Në debate/intervista janë përfshirë kandidatët për kryetar nga të gjitha SPÇ që garojnë në Gjakovë, të cilëve u është ofruar hapësirë e balancuar.

Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV SYRI VISION			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	32148	30.44	1	PDK	1138	16.72
2	AAK/LDD	44373	42.02	2	AAK/LDD	872	12.81
3	LDK	12016	11.38	3	LDK	894	13.14
4	ADK		0.00	4	ADK		0.00
5	PD	1012	0.96	5	PD		0.00
6	LSK		0.00	6	LSK		0.00
7	AKR	3100	2.94	7	AKR	1121	16.47
8	PSD	784	0.74	8	PSD		0.00
9	VV	8693	8.23	9	VV	1280	18.81
10	IRDK	991	0.94	10	IRDK		0.00
11	LB	340	0.32	11	LB		0.00
12	IQD		0.00	12	IQD		0.00
13	PSHDK	1490	1.41	13	PSHDK	1500	22.04
14	PDKI	320	0.30	14	PDKI		0.00
15	SDA		0.00	15	SDA		0.00
16	Vakat		0.00	16	Vakat		0.00
17	PFK	344	0.33	17	PFK		0.00
Total (s dhe %)		105611	100	Total (s dhe %)		6805	100.00

REGJIONI I PRIZRENIT

Shërbimet mediale audio-vizuele të këtij regjioni, TV Prizreni, TV Opinion dhe TV Besa, kanë dedikuar hapësirë dukshëm më të madhe në kronika dhe edicione të lajmeve për subjektin politik PDK. Në televizionet e këtij regjioni nuk janë realizuar debate dhe intervista me kandidatët e SPÇ-ve për kryetar të komunës.

TV BALLKAN – nuk ka mbuluar fare periudhën e fushatës zgjedhore.

TV PRIZRENI - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore hapësirë dukshëm më të madhe i ka dedikuar PDK-së, pasojnë BD, LDK dhe PK. TV Prizren nuk ka ofruar forma tjera të prezantimit të fushatës si debate apo intervista.

Raportimi ishte kryesisht i paanshëm. Në periudhën monitoruese ka ofruar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV PRIZRENI			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	22459	36.09				
2	LDK	6714	10.79				
3	AAK/LDD	1411	2.27				
4	BD	11642	18.71				
5	PK	6668	10.71				
6	NQP	248	0.40				
7	VV	2983	4.79				
8	AKR	4677	7.52				
9	ADK	5431	8.73				
Total (s dhe %)		62233	100.00	Total (s dhe %)		0	0.00

TV OPINION – Monitorimi i performancës së këtij shërbimi medial audio-vizuel, ka dëshmuar se gjatë prezantimit të fushatës për zgjedhjet lokale 2013, TV Opinion ka raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, ndërsa sa i përket hapësirës së ofruar subjektit politik PDK ishte më përfaqësuar në lajme dhe kronika zgjedhore. Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV OPINION			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	14650	35.87				
2	LDK	4552	11.15				

3	AAK/LDD	9585	23.47				
4	PK	6084	14.90				
5	VV	4387	10.74				
6	AKR	505	1.24				
7	PDKI	656	1.61				
8	PSHDK	424	1.04				
Total (s dhe %)		40843	100.00	Total (s dhe %)		0	0.00

TV BESA – Raportimi ishte kryesisht korrekt. Sa i përket hapësirës së ofruar në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore, ky televizion ka favorizuar dukshëm PDK-në . Pasojnë BD LDK, PK dhe AAK/LDD. Mbulimi i fushatave të partive më të vogla politike ishte më i balancuar.

Ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV BESA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	48376	37.79	1			
2	LDK	15021	11.73	2			
3	AAK/LDD	10004	7.81	3			
4	BD	16428	12.83	4			
5	PK	13180	10.29	5			
6	NQP	2615	2.04	6			
7	VV	5059	3.95	7			
8	AKR	6213	4.85	9			
9	ADK	5787	4.52	10			
10	PD	5342	4.17	11			
Total (s dhe %)		128025	100.00	Total (s dhe %)		0	0.00

TV Festina – hapësira e dhënë në lajme dhe kronika zgjedhore për SPÇ-të në këtë televizion ishte kryesisht e balancuar për subjektet më të mëdha politike, ndërsa raportimi ishte relativisht korrekt. Në debate/intervista nuk janë përfshirë dy subjekte, LDK dhe PD, që garojnë në komunën e Ferizajt.

Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore është dedikuar kjo hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV FESTINA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	3561	16.44	1	PDK	7478	20.94
2	LDK	4285	19.78	2	LDK		0.00
3	AAK/LDD	2678	12.36	3	AAK/LDD	6225	17.43
4	VV	3101	14.31	4	VV	9221	25.82
5	PD	3331	15.38	5	PD		0.00
6	AKR	1494	6.90	6	AKR	6225	17.43
7	VATRA	318	1.47	7	VATRA		0.00
8	YLLI ISUFI	240	1.11	8	YLLI ISUFI		0.00
9	NQF	1935	8.93	9	NQF	6225	17.43
10	PDAK	720	3.32	10	PDAK	345	0.97
Total (s dhe %)		21663	100.00	Total (s dhe %)		35719	100.00

TV HERC – Hapësira në kronika/edicione të lajmeve është dhënë vetëm për subjektet politike serbe që garojnë në këtë komunë. Hapësira e dhënë në kronika dhe edicione të lajmeve është e balancuar për dy subjektet serbe që garojnë për kryetar të Komunës së Shtërpces.

Hapësira e dhënë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV HERC			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	SLS	2061	44.13	1	SLS	2293	100.00
2	GI Srpska	2157	46.19	2	GI Srpska		
3	GI SDP	144	3.08	3	GI SDP		
4	DSS	308	6.60	4	DSS		
Total (s dhe %)		4670	100.00	Total (s dhe %)		2293	100.00

TV VALI - Në lajme dhe kronika zgjedhore, hapësirë më të madhe mbulimi dhe mbulim të balancuar ka ofruar për kandidatët e SPÇ-ve: PDK, LDK, AAK/LDD e VV. Raportimi ishte përgjithësisht korrekt. Në debate dhe intervista kanë munguar kandidatët për kryetar nga subjektet e PD, VATRA dhe Ylli Isufi.

Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV VALI			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	2347	22.77	1	PDK	10773	18.30
2	LDK	2069	20.07	2	LDK	13192	22.40
3	AAK/LDD	1918	18.61	3	AAK/LDD	8122	13.79
4	VV	1721	16.69	4	VV	8122	13.79
5	PD	815	7.91	5	PD		0.00
6	AKR	539	5.23	6	AKR		0.00
7	VATRA	464	4.50	7	VATRA		0.00
8	YLLI ISUFI	210	2.04	8	YLLI ISUFI		0.00
9	KGJ	176	1.71	9	KGJ	15442	26.22
10	ADK	50	0.49	11	ADK		0.00
11	Za Evropsko Pomoravlje		0.00	12	Za Evropsko Pomoravlje	3233	5.49
Total (s dhe %)		10309	100.00	Total (s dhe %)		58884	100.00

TV PULS- ka deklaruar se në programet e mëngjesit ka realizuar debate dhe intervista me një numër kandidatësh të nga radhët e SPÇ-ve serbe, bosnjake, malazeze, shqiptare dhe rome cilat nuk janë të prezantuara në tabelë pasi që në monitorim janë përfshirë përmbajtjet e transmetuara nga ora 17:00 deri në orën 24:00.

Bazuar në gjetjet nga monitorimi është vërejtur se subjekti GIS ka pasur hapësirën kryesore të mbulimit. Në debate/intervista hapësira më e madhe i është ofruar dy subjekteve politike serbe GIS dhe SLS. Ndërsa, SPÇ tjera janë përfshirë me hapësirë dukshëm më të vogël. Raportimi lidhur me fushatat zgjedhore të SPÇ-ve ishte relativisht neutral. Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore TV Puls ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: Puls			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	GIS	3011	52.67	1	GIS	42704	16.73

2	Narodna Partija	113	1.98	2	Narodna Partija	8972	3.52
3	Zajednicka buducnost	433	7.57	3	Zajednicka buducnost	14333	5.62
4	AKR	37	0.65	4	AKR		0.00
5	SLS	1142	19.98	5	SLS	39343	15.42
6	NCP		0.00	6	NCP	2049	0.80
7	DAG		0.00	7	DAG	2049	0.80
8	SAVEZ ROMA KOSOVA		0.00	8	SAVEZ ROMA KOSOVA	2049	0.80
9	NARODNA PRAVDA		0.00	9	NARODNA PRAVDA	8919	3.49
10	GI.SAVEZ KOS.SRBA		0.00	10	GI.SAVEZ KOS.SRBA	10632	4.17
11	GI.SIMONIDA		0.00	11	GI.SIMONIDA	10632	4.17
12	GI.NOVO BRDO	322	5.63	12	GI.NOVO BRDO	5455	2.14
13	SOCIJALDEMORKATIJA		0.00	13	SOCIJALDEMORKATIJA	8972	3.52
14	GI.KOSO.POMORAVLJE	213	3.73	14	GI.KOSO.POMORAVLJE	8972	3.52
15	SDP		0.00	15	SDP	8767	3.44
16	DI		0.00	16	DI	5294	2.07
17	GIZ		0.00	17	GIZ	5294	2.07
18	GI.PRIZREN	446	7.80	18	GI.PRIZREN		0.00
19	GI.OPSTANAK		0.00	19	GI.OPSTANAK	10910	4.27
20	SRPSKA GI		0.00	20	SRPSKA GI	10910	4.27
21	LDK		0.00	21	LDK	10910	4.27
22	PDK		0.00	22	PDK	16226	6.36
23	VV		0.00	23	VV	10910	4.27
24	AAK/LDD		0.00	24	AAK/LDD	10910	4.27
Total (s dhe %)		5717	100.00	Total (s dhe %)		255212	100.00

TV LIRIA - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore hapësira më e madhe i është ofruar dy subjekteve më të mëdha politike, PDK dhe LDK. Në debate/intervista hapësira e dhënë ka qenë kryesisht e balancuar me përjashtim të Subjektit Politik PDAK të cilit nuk i është ofruar hapësirë në debat.

Ky televizion ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV LIRIA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	3877	25.10	1	PDK	11196	16.18
2	LDK	3171	20.53	2	LDK	6228	9.00
3	AAK/LDD	1472	9.53	3	AAK/LDD	11196	16.18
4	VV	1904	12.32	4	VV	11196	16.18

5	PD	1257	8.14	5	PD	6228	9.00
6	AKR	1212	7.85	6	AKR	6228	9.00
7	NQF	1387	8.98	7	NQF	6228	9.00
8	PDAK	547	3.54	8	PDAK		0.00
9	PAI	622	4.03	9	PAI	771	1.11
10	Aleanca për Lipjanin		0.00	10	Aleanca për Lipjanin	4968	7.18
11	IQ për Lipjanin		0.00	11	IQ për Lipjanin	4968	7.18
Total (s dhe %)		15449	100.00	Total (s dhe %)		69207	100.00

TV TEMA – Gjatë prezantimit të fushatave zgjedhore të SPÇ-ve në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore, ky shërbim medial audio-vizuel ka raportuar kryesisht në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Hapësirë më e madha i është dhënë Subjektit Politik PDK gjë që është vërejtur edhe në hapësirën e ofruar në debate/intervista.

Në debate/intervista të realizuara nga ky televizion nuk janë përfshirë kandidatët nga SPÇ PDAK dhe PDI që garojnë për kryetar të Komunës së Ferizaj, ndërsa hapësirë iu është dhënë edhe kandidatëve nga komunat fqinje Lipjan dhe Shtime .

Hapësira e dhënë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV TEMA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	2812	20.02	1	PDK	24463	19.69
2	LDK	2046	15.28	2	LDK	19329	15.56
3	AAK/LDD	1766	13.19	3	AAK/LDD	14425	11.61
4	VV	1840	13.74	4	VV	12453	10.03
5	PD	1443	10.77	5	PD	7319	5.89
6	AKR	1266	9.01	6	AKR	12223	9.84
7	NQF	1075	8.03	7	NQF	7319	5.89
8	PDAK	1224	9.14				
9	PAI	572	4.27				
				8	Aleanca për Lipjanin	5134	4.13
				9	LB	7106	5.72
				10	Isuf Muslija	7106	5.72
				11	IQGTSH	3671	2.96
				12	PSD	3671	2.96

Total (s dhe %)	14044	100.00	Total (s dhe %)	124219	100
-----------------	-------	--------	-----------------	--------	-----

TV ILIRIA - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore hapësira më e madhe i është dhënë PDK dhe AAK/LDD, ndërsa nuk është mbuluar fushata e AKR, VV dhe PSHDK .Në debate dhe intervista TV Iliria ka ofruar hapësirë shumë të balancuar për të gjitha SPÇ që garuan në komunën e Vitisë. Hapësirë e dhënë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV ILIRIA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	7088	45.90	1	PDK	17559	17.08
2	LDK	2356	15.26	2	LDK	17559	17.08
3	AAK/LDD	5998	38.84	3	AAK/LDD	17559	17.08
4	AKR		0.00	4	AKR	17559	17.08
5	VV		0.00	5	VV	17559	17.08
6	PSHDK		0.00	6	PSHDK	14988	14.58
Total (s dhe %)				Total (s dhe %)			

Total (s dhe %)		2067	100.00	Total (s dhe %)		98	100

REGJIONI I MITROVICËS

TV MIR - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore, hapësira më e madhe i është dhënë subjekteve GIS dhe SDP. Ndërsa në debate/intervista hapësirë më e madhe është dhënë për DI. Për 4 subjekte tjera hapësira ka qenë e balancuar.

Ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV MIR			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	GIS	618	33.28	1	GIS	893	17.08
2	SKS	74	3.98	2	SKS		0.00
3	SLS	327	17.61	3	SLS	632	12.09
4	SDP	614	33.06	4	SDP	874	16.72
5	GIG	114	6.14	5	GIG		0.00
6	JSLD	110	5.92	6	JSLD		0.00
7	DI		0.00	7	DI	1918	36.69
8	NARODNA PRAVDA		0.00	8	NARODNA PRAVDA	911	17.43
Total (s dhe %)		1857	100.00	Total (s dhe %)		5228	100.00

TV MOST - Në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore hapësira më e madhe i është dhënë SPÇ-së GIS, që dëshmon anim në favor të këtij subjekti. Favorizimi subjektit politik GIS vërehet edhe në hapësirën e dhënë në debate e intervista. Për tri subjekte tjera politike hapësira ishte më e balancuar.

Ky televizion ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 03.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV MOST			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	GIS	11327	85.33	1	GIS	707	16.21
2	SLS	205	1.54	2	SLS	900	20.64
3	SDP	849	6.40	3	SDP	1861	42.67

4	ADRIJANA HODZIC	893	6.73		4	ADRIJANA HODZIC	893	20.48
Total (s dhe %)		13274	100		Total (s dhe %)		4361	100

TV MITROVICA – Pasi që nuk transmeton edicione të lajmeve, ky shërbim medial audio-vizuel ka bërë mbulimin e fushatës zgjedhore të subjekteve të certikuara politike përmes debateve dhe intervistave. Hapësira më e madhe i është dhënë SPÇ Të Pavarurit e Mitrovicës, ndërsa për të tjerat ka ofruar hapësirë kryesisht të balancuar. Ky televizion ka dhënë këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 09.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: TV Mitrovica			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1				1	Të Pavarurit e Mitrovicës	63689	20.78
2				2	PDK	53859	17.58
3				3	LDK	44019	14.37
4				4	AKR	41545	13.56
5				5	VV	40618	13.26
6				6	PD	29336	9.57
7				7	AAK	2474	0.81
8				8	Refki Suma	24128	7.87
9				9	Adriana Hodziq	2680	0.87
10				10	BSDAK	4080	1.33
Total (s dhe %)			100.00	Total (s dhe %)		306428	100

OSHP

RTK2 –Për shkak të pengesave teknike ofruesi i shërbimit programorë RTK2 është monitoruar nga data 9 tetor 2013. Në edicionet e lajmeve/ kronikat zgjedhore dhe debate RTK2 ka prezantuar fushatat e kandidatëve të SPÇ-ve të komuniteteve dhe atyre shqiptare. Raportimi ishte kryesisht korrekt.

Hapësira më e madhe është dedikuar për subjektet SLS dhe GIS, gjë që vlen edhe për hapësirën e dhënë në debate.

RTK2 ka dedikuar këtë hapësirë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 09.10.2013-01.11.2013	Subjekti transmetues: RTK 2
---	-----------------------------

Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	GIS	1734	18.41	1	GIS	24938	14.37
2	SOCIJAL DEMOKRATIJA	1589	16.87	2	SOCIJAL DEMOKRATIJA	4120	2.37
3	SDP	179	1.90	3	SDP	4706	2.71
4	SRPSKA NARODNA PARTIJA KOSOVA	342	3.63	4	SRPSKA NARODNA PARTIJA KOSOVA	2452	1.41
5	GI.ZAJEDNICKA BUDUCNOST	657	6.98	5	GI.ZAJEDNICKA BUDUCNOST	12755	7.35
6	SLS	2918	30.98	6	SLS	36505	21.03
7	PDK	250	2.65	7	PDK	16320	9.40
8	VAKAT	154	1.63	8	VAKAT	4481	2.58
9	DEMOKRATKSA INICIJATIVA	95	1.01	9	DEMOKRATKSA INICIJATIVA	6390	3.68
10	NARODNA INICIJATIVA		0.00	10	NARODNA INICIJATIVA	6390	3.68
11	LDK		0.00	11	LDK	9514	5.48
12	BUDUCNOST ZA NOVO BRDO		0.00	12	BUDUCNOST ZA NOVO BRDO	4938	2.85
13	AAK/LDD	27	0.29	13	AAK-LDD	4576	2.64
14	VV	37	0.39	14	VV		0.00
15	GI.KOSOVSKO POMORAVLJE		0.00	15	GI.KOSOVSKO POMORAVLJE	2452	1.41
16	CDU		0.00	16	CDU	4481	2.58
17	GIG	50	0.53	17	GIG	4481	2.58
18	SDA-SDSG		0.00	18	SDA-SDSG	4481	2.58
19	ADRIJANA HODZIC	42	0.45	19	ADRIJANA HODZIC	4706	2.71
20	SAVEZ KOSOVSKIH ROMA	100	1.06	20	SAVEZ KOSOVSKIH ROMA		0.00
21	SAVEZ KOSOVSKIH SRBA	839	8.91	21	SAVEZ KOSOVSKIH SRBA	2545	1.47
22	NOVA SNAGA		0.00	22	NOVA SNAGA	3261	1.88
23	CLS		0.00	23	CLS	3261	1.88
24	NCS		0.00	24	NCS	3261	1.88
25	GI.SIMONIDA		0.00	25	GI.SIMONIDA	2545	1.47
26	GIS(N)	319	3.39	26	GIS(N)		0.00
27	SLS(N)	87	0.92	27	SLS(N)		0.00
Total (s dhe %)		9419	100.00	Total (s dhe %)		173559	100

KLAN KOSOVA – Raportimi në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ishte kryesisht korrekt. Ky shërbim medial audio-vizuel ka dedikuar hapësirë më të balancuar për subjektet më të mëdha politike, si PDK, LDK, AAK/LDD dhe VV. Ndërsa, në debate/intervista hapësira më e madhe i është dhënë VV, AAK, LDD, PDK, LDK dhe AKR.

Një freski në mbulimin medial të fushatës parazgjedhore ishte gara e kandidatëve për Prishtinën, e cila u realizua përmes emisioneve shumë interesante dhe atraktive, në ambient të hapur dhe me pjesëmarrje të qytetarëve.

Përmes debateve me analistë, Klan Kosova ka analizuar paraqitjet në debate dhe programet e kandidatëve për kryetarë të komunave, duke ju mundësuar qytetarëve që të kenë pasqyrë më të qartë për garuesit dhe programet e tyre.

Hapësira e dhënë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 07.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: KLAN KOSOVA			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	12725	28.12	1	PDK	69333	19.98
2	LDK	11343	25.07	2	LDK	51170	14.74
3	AKR	3015	6.66	3	AKR	49321	14.21
4	VV	5873	12.98	4	VV	75875	21.86
5	AAK/LDD	8475	18.73	5	AAK/LDD	72555	20.91
6	PF	1305	2.88	6	PF	0	0.00
7	LB	1075	2.38	7	LB	8400	2.42
8	PD	268	0.59	8	PD	8218	2.37
9	Iniciativa Qytetare për Malishevën	316	0.70	9	Iniciativa Qytetare për Malishevën	3591	1.03
10	Iniciativa Qytetare për Drenasin	370	0.82	10	Iniciativa Qytetare për Drenasin	4200	1.21
11	Të Pavarurit e Mitrovicës	165	0.36	11	Të Pavarurit e Mitrovicës	4018	1.16
12	Bashkimi Demokratik		0.00	12	Bashkimi Demokratik	370	0.11
14	Adriana Hodziq	123	0.27		Adriana Hodziq	0	0.00
15	Lëvizja Vatra	27	0.06		Lëvizja Vatra	0	0.00
16	PSHDK	108	0.24		PSHDK	0	0.00
17	PSD	61	0.13		PSD	0	0.00
Total (s dhe %)		45249	100.00	Total (s dhe %)		347051	100.00

RROKUM TV – prezantimi i fushatave të SPÇ-ve në edicionet e lajmeve dhe kronikat zgjedhore ishte përgjithësisht korrekt. Sa i përket hapësirës së ofruar prijnë VV, PD, AAK/LDD dhe LDK, ndërsa në debate hapësirë me e madhe është dhënë për AKR, AAK/LDD dhe VV. Hapësira e dhënë për SPÇ-të:

Periudha monitoruese: 07.10.2013-01.11.2013				Subjekti transmetues: Rrokum TV			
Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%	Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	5000	8.45	1	PDK	11056	6.86
2	LDK	8918	15.08	2	LDK	5650	3.51
3	AKR	1953	3.30	3	AKR	26922	16.71
4	VV	13965	23.61	4	VV	23621	14.66
5	AAK/LDD	10191	17.23	5	AAK/LDD	26301	16.33
6	PF	3112	5.26	6	PF	4255	2.64
7	LB	1924	3.25	7	LB	12304	7.64
8	PD	11065	18.71	8	PD	10049	6.24
10	Iniciativa Qytetare për Drenasin	1092	1.85	10	Iniciativa Qytetare për Drenasin	3630	2.25
11	Të Pavarurit e Mitrovicës	1760	2.98	11	Të Pavarurit e Mitrovicës	3917	2.43
12	Bashkimi Demokratik	0	0.00	12	Bashkimi Demokratik	0	0.00
13	Adriana Hodziq	0	0.00		Adriana Hodziq	1943	1.21
14	Lëvizja Vatra	0	0.00		Lëvizja Vatra	0	0.00
15	PSHDK	0	0.00		PSHDK	0	0.00
16	PSD	0	0.00		PSD	8235	5.11
17	Iniciativa Qytetare për Lipjanin	0	0.00		Iniciativa Qytetare për Lipjanin	3630	2.25
18	GIS	0	0.00		GIS	13903	8.63
19	Kosova Turk Adalet Partisi	159	0.27		Kosova Turk Adalet Partisi	0	0.00
20	Partia Turke e Drejtësisë	0	0.00		Partia Turke e Drejtësisë	1763	1.09
21	Rufki Suma	0	0.00		Rufki Suma	3917	2.43
Total (s dhe %)		59139	100.00	Total (s dhe %)		161096	100.00

First Channel – Gjatë mbulimit të fushatës për zgjedhjet lokale 2013, **First Channel ka prezantuar në mënyrë relativisht korrekte fushatat dhe aktivitetet e SPÇ-ve**. Në kronika zgjedhore hapësira më e madhe është dhënë për subjektet politike AAK/LDD, ndërsa në debate hapësira më e madhe i është ofruar VV dhe LDK.

Hapësira e dhënë për SPÇ-të:

Nr.	SPÇ në lajme dhe kronika zgjedhore	Koha (s)	%		Nr.	SPÇ në debate/intervista	Koha (s)	%
1	PDK	0	0.00		1	PDK	1393	2.36
2	LDK	228	3.13		2	LDK	14588	24.68
3	AKR	64	0.88		3	AKR	7926	13.41
4	VV	0	0.00		4	VV	15761	26.66
5	AAK/LDD	2100	28.83		5	AAK/LDD	5096	8.62
6	PF	330	4.53		6	PF	3174	5.37
7	LB	330	4.53		7	LB	6075	10.28
8	PD	740	10.16		8	PD	0	0.00
11	Të Pavarurit e Mitrovicës	721	9.90		11	Të Pavarurit e Mitrovicës	5096	8.62
15	PSHDK	544	7.47			PSHDK	0	0.00
16	PSD	623	8.55			PSD	0	0.00
17	Aleanca për Lipjanin	480	6.59			Aleanca për Lipjanin	0	0.00
20	Nisma Qytetare për Prizrenin	570	7.83			Nisma Qytetare për Prizrenin	0	0.00
21	Rufki Suma	104	1.43			Rufki Suma	0	0.00
	Visar Grejgevc	160	2.20			Visar Grejgevc	0	0.00
	Yll Isufi	173	2.38			Yll Isufi	0	0.00
	Festim Xhymshiti	44	0.60			Festim Xhymshiti	0	0.00
	LSK	72	0.99			LSK	0	0.00
Total (s dhe %)		7283	100.00		Total (s dhe %)		59109	100.00

Përfundim

Është konstatim i përgjithshëm nga mbulimi i fushatës për Zgjedhjet Lokale 2013, se shërbimet mediale audio-vizuele kanë informuar në përgjithësi në mënyrë të drejtë dhe korrekte, duke vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Kapitullin VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Gjatë mbulimit të fushatës parazgjedhore, shumica e shërbimeve mediale audio-vizuele duke ofruar diversitet programesh me lajme, kronika, debate e intervista, kanë arritur të pasqyrojnë atmosferën elektorale dhe kanë ndihmuar elektoratit që të krijojnë një pasqyrë më të qartë për procesin zgjedhor.

Gjatë periudhës monitoruese, shërbimet mediale audiovizuele kanë ofruar edhe materiale edukuese lidhur me procesin e votimit, që konsiderojmë se ishte ndihmesë për qytetarët në ditën e votimit, më 03 nëntor 2013.